



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUSTEC
KËSHILLI BASHKIAK

Pustec, më 28.01.2026

PROCESVERBAL

Lloji i mbledhjes: e rregullt

Vendi i mbledhjes: salla e mbledhjeve të Këshillit

Ora e fillimit: 12⁰⁰

Kryeson mbledhjen: kryetari i këshillit z. Naum Damo

Të pranishëm nga administrata janë: sp. NE znj. Marjeta Serbin, znj. Para Trajko, sp. projekteve dhe ndihmës së huaj znj. Klaudia Konopulli, sp. jurist znj. Klodjana Sotiri

Këshilltarë të pranishëm në sallë janë: Naum Damo, Spase Tërpo, Vasilika Kolefski, Vaska Vasilovski, Taqo Grozdani, Jordan Jankulla, Jani Apostol, Nada Gjoli.

Kryetari i këshillit: përshëndetje të gjithëve, fillojmë me kourumin e mbledhjes, këshilltarë të pranishëm janë **tetë**, kuorumi miratohet. Faleminderit!

Në mbështje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 52 “konflikt interesi” të gjithë këshilltarët që jemi të pranishëm duhet ta plotësojmë deklaratën e konfliktit të interesit.

Shënim: asnjë këshilltar nuk është në konflikt interesi me pikat e rendit të ditës

Faleminderit!

Vazhdojmë me shtjellimin e pikave të rendit të ditës

1. Për miratimin e rendit të ditës së mbledhjes

Kryetari i këshillit: Ka ndonjë pyetje? E kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet me 8 vota pro. Faleminderit !

2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryetari i këshillit: Pyetje ka? e kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet me 8 vota pro. Faleminderit!

3. Për miratimin e bllok ndihmës ekonomike nga fondi 6% për muajin Dhjetor 2025

Sp.NE-përshëndetje, në bazë të verifikimeve të bëra nga grupi i kontrollit i ngritur nga ana e Bashkisë për verifikimin e familjeve të cilët kanë dalë jo përfituese nga skema e ndihmës ekonomike, të cilat do të trajtohen nga fondi i kushtezuar për bllok-ndihmen ekonomike deri në 6% rezultojnë për këtë muaj nuk kemi ndryshime.

Këshilltari Jordan Jankulla- pse nuk vendosi persona te tjerë?

Sp.NE: duhet të bëjnë aplikim dhe të dalin në system që nuk i kanë marrë pikët e mjaftueshme dhe të përfitojnë.

Kryetari i këshillit: Pyetje ka? nëse jo e kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet me 8 vota pro dhe 0 kundër, 0 abstenim. Faleminderit!

4. Kriteret për familjet që trajtohen sipas fondit të kushtezuar për bllok ndihmën deri 6% për vitin 2026

Sp.PAK -Ky relacion shpjegues argumenton domosdoshmërinë e miratimit të kriterëve dhe procedurës për trajtimin me ndihmë ekonomike të familjeve në nevojë nga fondi i kushtezuar 6%, jashtë sistemit të pikëzimit. Projekt-vendimi synon mbështetjen e kategorive sociale që, për arsye objektive, nuk përfitojnë nga skema e rregullt e ndihmës ekonomike, por ndodhen në vështirësi të theksuara ekonomike dhe sociale. Ai mbështetet në legjislacionin në fuqi dhe buxhetin e vitit 2026, përcakton qartë kategoritë përfituese, kriteret dhe procedurat e trajtimit, duke garantuar transparencë dhe barazi.

Këshilltari Taqo Grozdani- këto kriterë ju vijnë të gatshme?

Sp.PAK-po po janë publikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Këshilltari Taqo Grozdani-këtu nuk ka ndonjë gjë që mund ta ndryshojmë ne?

Sp.PAK-jo, dhe e vetmja arsye që të trajtohen familjet ose personat me këto kriterë është që të dalin me pikë të pamjaftueshme nga skema e ndihmës ekonomike.

Këshilltari Jordan Jankulla- është një familjar nga fshahti Kallamas që me të vërtetë është një një gjendje shumë të keqe shëndetësore, është thuhetse invalid ecën me paterica, pse smund të trajtohet ai me ndonjë ndihmë?

Sp.PAK- ai mund të shkonte tek një mjek specialist ti bënte një diagnozë në bazë të problemit që ka dhe do ti bënte dokumentet dhe mund të trajtohej.

Këshilltari Jordan Jankulla- na tregoni pas mbledhjes se çfarë duhet të bëjmë që edhe ai të mundet të trajtohet me ndihmë ose kemp.

Kryetari i këshillit: Pyetje ka? nëse jo e kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet me 8 vota pro dhe 0 kundër, 0 abstenim. Faleminderit!

5. Për miratimin e Planit 5-vjeçar të Strehimit

Sp.PAK- Ky projekt-vendim synon miratimin e Programit 5-vjeçar të Strehimit Social të Bashkisë Pustec për periudhën 2026–2030. Programi bazohet në analizën e nevojave për strehim dhe adreson kategoritë më në nevojë, si familjet në varfëri ekstreme, familjet që jetojnë në banesa të pasigurta, familjet e reja dhe ato në risk social. Ai parashikon burimet e financimit, procedurat për përzgjedhjen e përfituesve, rehabilitimin e banesave ekzistuese, përdorimin e fondit rezervë dhe nxitjen e partneriteteve. Zbatimi i programit do të realizohet brenda mundësive buxhetore dhe kontribuon në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe garantimin e të drejtës për strehim në Bashkinë Pustec.

Këshilltari Taqo Grozdani-cfarë do të thotë ky plan?

Sp.PAK-një herë në pesë vite e miratojmë planin e ri 2026-2030, duhet të miratohet

Këshilltari Taqo Grozdani-cfarë përmban plani?

Sp.PAK- thelbi i këtij plani është për rikonstruksionin e banevave që po bëhen aktualisht.

Këshilltari Taqo Grozdani-Aplikantët të cilët kanë alipuar deri tani do të merren parasysh me planin e ri?

Sp.PAK-po ato janë të vlefshme për të pesë vitet e ardhshme, dhe për të gjithë aplikantët.

Kryetari i këshillit: Pyetje ka? nëse jo e kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet me 8 vota pro dhe 0 kundër, 0 abstenim. Faleminderit!

6. Për disa ndryshime në VKB nr 101 datë 24.12.2025 “Për miratimin e numrit të punonjësve nivelin e pagave të administratës dhe agjencisë të Bashkisë Pustec për vitin 2026.

Sp.jurist- kemi vetëm një ndryshim për pozicionet që janë poshtë pagës 50000 lekë ka vendosur qeveria në bazë të VKM nr.776 dt.19.12.2025 Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi , kemi vendosur që të gjithë ata punonjës që paguheshin deri tani me pikën 11 nga 40000-47000 tani kaluan tek 50000 lekë.

Këshilltari Jordan Jankulla-vetëm ky ndryshim ishte?

Sp.jurist-kemi edhe ndryshimin e pagës së përgjegjësit së Gjendjes Civile ku u kthye nga Prefektura sepse klasa e pagës nuk përkon me grupin e diplomës, se nuk ka master shkencor, dhe në bazë të VKM nr. 325, datë 31.05.2023 do të paguhet si specialiste me një kategori tjetër më bazë të diplomës që ka në masën 70000 lekë që ekziston në këtë kategori, është gjetur si shkelje nga ana e Prefekturës.

Kryetari i këshillit: Pyetje ka? nëse jo i kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohen me 7 vota pro dhe 1 votë kundër, 0 abstenim. Faleminderit!

Kryetari i këshillit: kalojmë dek diskutimet

Informacion i performancës të Këshillit Bashkiak Pustec për vitin 2025

Gjatë vitit 2025, Këshilli Bashkiak Pustec ka ushtruar në mënyrë të rregullt funksionet e tij vendimmarrëse, duke miratuar gjithsej **104 vendime**, kryesisht me propozim të ekzekutivit. Procedurat e shqyrtimit dhe miratimit kanë qenë korrekte, pa ndryshime të projektakteve gjatë diskutimit në komisione dhe në këshill, dhe të gjitha vendimet janë miratuar **me unanimitet**.

Aktet e Këshillit janë publikuar dhe bërë të zbatueshme, ndërsa **95% e tyre janë konfirmuar nga Prefekti**, me rishqyrtim dhe miratim të përsëritur për aktet e kontestuara. Këshilli ka qenë i përfshirë në proceset e konsultimit publik, veçanërisht për paketën fiskale dhe buxhetin 2026.

Në vitin 2025 nuk janë paraqitur ankesa, kërkesa apo peticione drejtuar Këshillit, por pritjet rritje e këtij procesi me publikimin e regjistrit përkatës. Mbështetja e **Projektit “Bashki të Forta”** ka kontribuar në forcimin e kapaciteteve teknike dhe funksionale të Këshillit.

Për vitin 2026, mbetet sfida zbatimi më efektiv i rregulloreve dhe forcimi i punës së komisioneve, me qëllim rritjen e cilësisë së vendimmarrjes dhe përfshirjes së këshilltarëve.

Shënim: Në lidhje me shkresën “Mbi përdorimin e fondit të grantit të bazuar në performancë për vitin 2025”, u paraqitet një paqartësi lidhur me:

Përdorimin e fondit për blerjen e një varke turistike

Përdorimin e fondit për pagat e aparatit të bashkisë

Për sa më sipër informojmë se në mbledhjen e ardhshme të Këshillit Bashkiak do të paraqiten për miratim dy projekt vendime të veçanta, konkretisht:

Detajimin e Fondit të Grantit të Bazuar në Përfundimin për Bashkitë për Vitin 2025 me Burim Financimi të Huaj

Detajimin e Fondit të Grantit të Bazuar në Përfundimin për Bashkitë për Vitin 2025 Burim Financimi nga Buxheti i Shtetit

MIRATUAN

Sekretar i këshillit

Todora TËRPO



Kryetari i këshillit

Naum DAMO

